

URDHËR
Nr. 726, datë 7.12.2022

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, GJIMNAZI “ÇELËSI MAGJIK”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, gjimnazit “Çelësi Magjik”, të subjektit juridik “Çelësi Magjik” sh.p.k., i hapur me urdhrin nr. 280, datë 31.7.2007, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në emër të këtij subjekti, me kërkesën e tij për mbylljen e veprimtarisë arsimore nr. 148 prot., datë 29.8.2022.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, gjimnazit “Çelësi Magjik”, ka këto detyrime:

a) të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të frekuentimit të institucionit arsimor parauniversitar privat, për vitin shkollor 2022–2023, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur, nëse ka;

b) të vendosë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet institucioni arsimor parauniversitar privat, gjimnazi “Çelësi Magjik” ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, “Çelësi Magjik”;

b) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga ky institucion arsimor parauniversitar privat;

c) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë, sipas legjislacionin në fuqi për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, “Çelësi Magjik”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast moszbatimi të detyrimeve, nga institucioni parauniversitar privat, gjimnazi “Çelësi Magjik”, të përcaktuar në pikën 2, të këtij urdhri, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 280, datë 31.7.2007, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Shkollë e mesme e përgjithshme “Çelësi Magjik”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në MAS, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar privat, gjimnazi “Çelësi Magjik” dhe personi juridik “Çelësi Magjik” sh.p.k.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi